

MONITOR: ZBATIM I REFORMAVE URGJENTE PRIORITARE

Periodha: 1-20.10.2015.

Ngecje në negociata ose rezistencë e organizuar?

Zbatimi i Marrëveshjes politike është në krizë serioze. Madje as komisari i KE për zgjerim dhe negociata për aderim, Johannes Han nuk arriti të zhblokon negociatat deri në mëngjesin e 20 tetorit të vitit 2015.

Ka kaluar afati për pakon e mbetur të Marrëveshjes pas kthimit të opozitës në Parlament dhe emërimin e prokurorës speciale publike: zgjedhja e ministrave të ri (afati: 20 tetor), legjislacionin zgjedhor¹, themelimi i Komisionit për anketa për skandalin me përgjimet (20 tetor).

Prokurorja speciale publike ballafaqohet me pengesa të mëdha në nismën e punës. Këshilli për prokuror publik zgjodhi vetëm gjysmën e ndihmësve të propozuar nga ajo, dhe është dorëzuar një iniciativë tek Gjykata Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit mbi të cilin u themelua ky institucion.

Goditje tjetër serioze për Marrëveshjen politike ishte propozimi i dorëzuar nga deputet të partive qeveritare me të cilin ndalohet publikimi i “bombave”.² Përsëri me intervenim të bashkësisë ndërkombëtare, ligji u tërhoq me premtim se do të shqyrtohet në pako me ligjin për mbrojtje të kallëzuesve.

Përfshirja e dukshme e faktorit ndërkombëtar që të respektohet marrëveshja deri tani nuk ka pasur efekt. Nga ana tjetër, reaksionet në publik vazhdojnë të polarizohen – tani jo vetëm mes pushtetit dhe opozitës, mes medieve pro-qeveritare dhe atyre kritike ndaj qeverisë, mes ekspertëve pro-qeveritar dhe atyre kritik ndaj qeverisë, por më mjaftë janë shpeshuar dhe janë të shume zëshëm edhe reagimet nga prokurorët publik dhe gjykatat.

Vazhdon pasiguria rreth ndikimit të moszbatimit të marrëveshjes mbi përsëritjen e rekomandimit për anëtarësim në BE, pasi u anulua shpallja e raporteve të rregullta të KE për këtë vit.

Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori

Gjyqësori

Përçarje ose lëvizje?

Në seancën e mbajtur më 14 tetor, Këshilli i prokurorëve publik me votim sekret vendosi për 7 në vend të 14 prokurorëve publik të cilat i propozoi **prokurorja speciale publike** Katica Janeva.³ Këshilli e arsyeoi vendimin vlerësimin e nevojave të prokurorisë speciale dhe mungesës së kapaciteteve me të cilën punojnë prokurorët në vend. Arsyetimi përshtatet me qëndrimin e kolegjiut të prokurorëve publik të shpallur ditën e njëjtë.⁴ Si duket resurset dhe pagat më të larta të prokurorëve special kanë shkaktuar reaksion tek kolegjet e tyre. Prokuroria me vite të tëra nuk arrin të siguron resurset e duhura për realizimin e Ligjit të ri për procedurë penale, por ky problem tani u bë i dukshëm.

Janeva vazhdon të kërkon zgjedhjen e ekipit të plotë. Nën shtypjen e faktorit ndërkombëtar, partitë nënshkruese janë akorduar të dërgojnë letër Këshillit të prokurorëve publik duke kërkuar zgjedhjen e ekipit të plotë të prokurorës speciale publike. Prokurorët e zgjedhur, sipas thirrjes së Janevës, nuk morën pjesë në dhënien e betimit para Këshillit.

Sa i përket transparencës së prokurorës speciale publike, mund të konstatohet se respektohet neni 8 nga Ligji për Prokurori Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhur me dhe që dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimit, që ka të bëjë me marrëdhëniet me marrëdhëniet me publikun, për shkak të faktit që prokurorja vazhdimisht njofton publikun për të gjitha hapat që i ka ndërmarr deri tani. Këtë konstatim e konfirmon edhe informata e dhënë nga prokurorja se e kontaktojnë persona që posedojnë të dhëna të rëndësishme për hetimin, me qëllim që të bëhen dëshmitar të mbrojtur në procedurat penale eventuale që duhet nisur.

Diskutimi nëpërmjet medieve ende më shumë ka shqetësuar publikun. Deklarata e Janevës se do të jep dorëheqje nëse refuzohet madje edhe vetëm një prokuror nga lista e prokurorëve të propozuar⁵, Këshilli i prokurorëve

¹Legjislacioni zgjedhor nuk ka afat në vet marrëveshjen, por komisar Han insistonte që kjo të harmonizohet deri më 6 tetor.

²Materialet nga përgjimet e paligjshme.

³Burim Rustemi, Elizabeta Josifovska, Lejla Kadriu, Ljubomir Lape, Marija Gjorgjeva, Stevço Donev dhe Fatime Fetai

⁴Njoftimi i Prokurorisë publike të RM. Ueb-faqja e PPRM. 14.10.2015. Në dispozicion në: <http://jorm.gov.mk/?p=2188>

⁵Edhe një nëse nuk ia zgjedhin, Katica jep dorëheqje. Vest. 08.10.2015. Në dispozicion në:

e vlerësoi si shtypje të drejtpërdrejtë mbi prokurorinë⁶. Kurse prokurori publik Marko Zvrlevski deklaroi se formimi i prokurorisë speciale publike është politike, se është ofendim dhe shkakton revolt tek prokurorët publik, dhe se prokuroria “e rregullt” është e pavarur.⁷ Ai paralajmëroi se do të nis iniciativë tek Gjykata kushtetuese kundër Ligjit për prokurori speciale.⁸

Konflikti mes prokurorisë publike “të rregullt” dhe “speciale” është i dukshëm edhe në rastin “**Puç**”. Lideri i opozitës Zaev nuk u paraqit në seancën e tretë të rastit “Puç” më 5 tetor, me paralajmërim se do të paraqitet në gjyq në çastin kur rastin do ta merr prokurorja speciale publike. Kurse prokurori Bikovski deklaroi se ai konsiderohet si kompetent për lëndën.⁹ Nga ana tjetër, Gjykata themelore Shkup 1, më 2 tetor refuzoi kërkesën e Prokurorisë publike të merr pasaportën e Zoran Zaevit, si i akuzuar në rastin “Puç”, dhe e ndaloi masën sipas cilës Zaevi u obligua q një herë në javë të paraqitet para gjykatësit kompetent në gjyqin e Strumicës.

Në seancën e shqyrtimit për rastin “**Rover**”, kundër ish ministrit për punë të brendshme Lube Boshkovski, avokatët e të akuzuarve kanë theksuar se do të kërkojnë që rasti të merret nga prokurorja speciale publike për shkak të ekzistimit të pretenduar të incizimeve për këtë rast.¹⁰

Këshilli gjyqësor publikoi shpallje më 2 tetor, për zgjedhje të dy anëtarëve të Këshillit për përcaktim të fakteve dhe nisjen e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatësit, nga profesor të pensionuar të Fakultetit juridik në universitetet e RM.¹¹ Këshilli nuk ka nisur me punë, pasi ende nuk është formuar në tërësi ekipi i tij.¹²

Më 8 tetor Këshilli gjyqësor mbajti seancë urgjente ku morri vendim për heqjen e imunitetit të kryetarit të Gjykatës themelore në Kumanovë¹³, pas kërkesës së dorëzuar tek Prokuroria themelore publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit në Shkup.¹⁴ Atij ju caktua masa paraburgim prej 30 ditësh, nën dyshim se ka marr mitë në shumë prej 25 000 euro për lirim nga paraburgimi. Zëvendës i përkohshëm është zgjedhur Bexhet Elezi, gjykatës në Gjykatën themelore në Kumanovë.

Këshilli gjyqësor informoi për mbajtjen e Tryezës së dytë të rumbullakët të KGJRM në javën e fundit të tetorit 2015¹⁵, ku është propozuar të lihet më shumë hapësirë për diskutim nga gjykatësit dhe të ftohen vetëm gjykatës, dhe jo zëvendës të gjyqeve sikur në tryezën e parë të rumbullakët, pasi anëtarët kanë informata se kryetarët e gjyqeve ndikojnë mbi gjyqtarët. Këto aktivitete, të paralajmëruar si pjesë e “Planit të aksionit” duhet të kontribuojnë për transparencën e Këshillit gjyqësor, por pritet edhe pjesëmarrja e publikut të gjerë.¹⁶

Kryetarja e Gjykatës supreme, Lidija Nedelkova, ka paralajmëruar zbatimin e anketimit të gjykatësve, së bashku me kryetarin e Shoqatës së gjykatësve, Nikolço Nikolovski, “që të dëshmojnë se nuk ka shtypje politike në gjyqësorin”. Gjatë kësaj, ajo ka vlerësuar se anketa e zhvilluar nga misioni i OSBE në vitin 2009 nuk e shfaq gjendjen e vërtetë.¹⁷ Ndryshe, kjo anketë e cila ishte anonime, tani më është pranuar si burim relevant për gjendjen në gjyqësorin në Republikën e Maqedonisë.¹⁸

<http://www.vest.mk/default.asp?ItemID=745146CFCD0B49488E68438A9A1D7F27>

⁶Katica na kërcënohet. Vest. 09.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.vest.mk/default.asp?ItemID=7129C0D527E8B643BBAFD927D9267CE8>

⁷Njoftimi i Prokurorisë publike të RM. Ueb-faqja e PPRM. 14.10.2015. Në dispozicion në: <http://jorm.gov.mk/?p=2188>

⁸Iniciativa e tillë vetëm më është dorëzuar nga avokati Tome Todorovski.

⁹Nga ndjekja e rregullt e rasteve gjyqësore të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”.

¹⁰Nga ndjekja e rregullt e rasteve gjyqësore të Komisionit të Helsinkit për të drejtat e njeriut.

¹¹Shpallje për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit për përcaktim të fakteve dhe nisje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatës. Këshilli gjyqësor i RM. 02.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=350>. Instituti për të drejta të njeriut rregullisht ndjek seancat e Këshillit gjyqësor.

¹²Deri tani janë zgjedhur 7 anëtarë: Zlata Stamboliska (241 votë), Jordan L Lazarov (206) dhe Faton Paçiku (199) nga gjykatësit e pensionuar; Ivan Jakimovski (375), Kire Sekulovski (375) dhe Feta Iseini (375) nga prokurorët publik të pensionuar dhe Sasho Pocevski (281) nga avokatët e pensionuar. Zgjedhja u shpall më 15 korrik të këtij viti. Në listën zgjedhore të emrave të gjykatësve kanë shënuar 594 votues (gjykatës), nga të cilët 535 kanë votuar. Numri i votave të pavlefshme është 160, kurse fletëvotime 59 janë të papërdorura. Njoftimi i Këshillit gjyqësor për zgjedhjet e zbatuar të anëtarëve të Këshillit për përcaktim të fakteve dhe nisje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatësit. 15.07.2015. Në dispozicion në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=332>

¹³Njoftim nga Këshilli gjyqësor. Ueb-faqe e Këshillit gjyqësor. 08.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=352>

¹⁴Prokuroria publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit vepron kundër 12 personave të arrestuar në aksionin e sotshëm. Ueb-faqe e PPRM. 08.10.2015. Në dispozicion në: <http://jorm.gov.mk/?p=2181>

¹⁵E para, me temën “Roli i Këshillit të gjyqeve dhe gjykatave më të larta në mbrojtjen e gjykatësve nga ndërhyrjet në pavarësinë e tyre” u mbajt më 28 shtator.

¹⁶Nga ndjekja e rregullt e seancave të Këshillit gjyqësor që i zbaton Instituti për të drejta të njeriut – Shkup.

¹⁷Kryetarja e Gjykatës Supreme nuk i beson OSBE-së. Prizma.10.2015. Në dispozicion në: <http://prizma.birn.eu.com/%D0%BC%D0%BA/%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B8/%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B2%D1%80%D1%85%D0%BE%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D1%81%D1%83%D0%B4-%D0%BD%D0%B5-%D0%BC%D1%83-%D0%B2%D0%B5%D1%80%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D0%B1%D1%81%D0%B5>

¹⁸OSBE, Pavarësia në gjyqësor – analizë juridike, dhjetor 2009. Në dispozicion në: <http://www.osce.org/mk/skopje/67585?download=true>

Gjykata supreme e RM ka njoftuar për promovimin e **data-bazës së re qendrore dhe ueb faqes** nëpërmjet cilës do të shpallen vendimet e të gjithë gjykatave në vend. Por, data-baza e re nuk do të përmban vendimet e gjyqeve vetëm më të publikuar në ueb faqet e posaçme të gjykatave.¹⁹

Prokurori Jovan Ilievski, i cili udhëheq me Prokurorinë themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit është zgjedhur për **kryetar i Komisionit për barazim të politikave dënuese**, me propozim të Prokurorisë publike.²⁰ Siç pritej, kjo zgjedhje shkaktoi reaksione të forta nga LSDM-ja opozitare.²¹

Në leximin e dytë në Kuvend është **Propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik**. Propozim ligji parasheh mbrojtje elektronike gjatë zbatimit të provimeve, kontroll më të madh gjatë mbajtjes së provimeve dhe sanksione kundërvajtjeje për shkeljen e këtyre dispozitave ligjore. Propozimi synon të rrit transparencën nëpërmjet kërkesës për shpallje publike për kandidatë për Këshillit programor nga profesor dhe jurist të dalluar dhe nëpërmjet ofrimit të informatave publike për datën dhe kohën e mbajtjes së provimit të kandidatëve vetëm më të zgjedhur. Ligji i propozuar vazhdon praktikën normative vetëm më të themeluar për përdorim të teknikës për vendimet dhe paraqitjen e dispozitave të reja ndëshkuese, pa qasje ndaj problemit themelor. Me këtë ligj nuk kemi përpjekje të reja për zgjidhje të problemeve themelore – mungesë e kandidatëve nga Akademia dhe avancim i cilësisë së trajnimit.

Pasaportë të re dhe pistoletë në çantë të vjetër?

Nuk ndalon preokupimi i publikut me ish drejtorinë e DSK Sasho Mijalkov. Ai, nën shtypje të publikut ktheu pasaportën diplomatike të dhënë pa bazë ligjore (si “ekspert”).²² Akoma më skandaloze ishte ndalimi i tij në aeroportin e Beogradit për shkak të zbulimit të pistoletës në valixhe, kurse pastaj edhe lirimi pas intervenimit të përfaqësuesve të lartë të pushtetit maqedonas. Ngjarja nxiti pyetjen mbi sigurinë në aeroportin e Shkupit, prej ku është nisur Mijalkov, dhe për këtë TAV njoftoi se do të ketë hetim.²³

Ndjekja e komunikimeve

Përpjekje për censurë, derisa komisionet e Kuvendit ende janë duke u përgatitur

Deputetët e VMRO-DPMNE dhe BDI më 6 tetor dorëzuar Kuvendit Propozim ligj për ndalim të posedimit, përpunimit, publikimit dhe dispozicionit të materialeve nga ndjekja e paligjshme të komunikimeve. Me propozim-ligjin përcaktohet ndalesë për posedim, përpunim, publikim nëpër medie, rrjete sociale, ueb-portale dhe çfarëdo forme tjetër të publikimit dhe dispozicionit të çfarëdo lloji me materialet nga ndjekja e paligjshme të komunikimeve, përfshirë edhe përdorimi dhe posedimi i tyre në procesin zgjedhor, kurse parasheh edhe përgjegjësi penale për shkeljen e dispozitave. Në publik ligji u vlerësua si përpjekje për themelimin të censurës dhe çrregullimin e marrëveshjes politike. Përsëri me intervenim të bashkësisë ndërkombëtare, ligji u tërhoq me premtim se do të shqyrtohet në pako me ligjin për mbrojtje të “kallëzuesve”.

Komisionet parlamentare²⁴ për mbikëqyrje të ndjekjes së komunikimeve dhe punën e Shërbimeve të zbulimit më 6 tetor, shqyrtuan Reformat urgjente prioritare dhe rekomandimet nga Raporti i grupit të ekspertëve, të udhëhequr nga Pribe.²⁵ Pavle Sazdov, deputet i VMRO-DPMNE, tregoi rezervë për të gjitha rezultate të raportit, duke konsideruar se nuk është e mundshme që për 7 ditë të bëhet vlerësim real i gjendjes politike dhe sigurisë në vend.

Në seancë u vendos se është e domosdoshme reforma e shërbimeve të sigurisë, ku rëndësi të madhe ka funksionimi i sistemit të kontrollit parlamentar. Për këtë qëllim, nevojitet komunikim i rregullt dhe i papenguar me DSK dhe AK, si dhe angazhim i ekspertëve teknik dhe përfshirje e publikut profesional në seancat publike. Anëtarët e

¹⁹Informacioni është shpërndarë në tryezë të rrumbullakët me temë “Transparencë më e madhe e gjyqësorit dhe barazim i praktikës gjyqësore nëpërmjet publikimit të vendimeve gjyqësore dhe emrave të vendimeve”, organizuar nga Gjykata supreme, më 29 shtator. Ndjekja e aktivitetëve të Gjykatës supreme është aktivitet i rregullt i Komisionit të Helsinkit.

²⁰Komisioni është themeluar në bazë të Ligjit për përcaktim të llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, që hyri në fuqi më 7 janar 2015. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë zgjodhi përbërjen e personalit të Komisionit për barazim të politikës dënuese në seancën e 63-të, mbajtur më 26 gusht të këtij viti.

²¹LSDM reagoi ashpër zgjedhjes së tillë, pasi bëhet fjalë për baxhanakun e ish drejtorit të drejtorisë për kundërzbulim: Gruevskit dhe Mijalkovit asgjë nuk mund të ju ndihmon, as baxhanaku e as kumbari. Ueb-faqja e LSDM. 02.10.2015. Në dispozicion në:

<http://www.sds.org.mk/default.aspx?mId=55&aqlD=6&articleId=12443>

²²Pasaporta diplomatike e Mijalkovit është anuluar me vulë prej sot. Telma. 8.10.2015. Në dispozicion në: <http://telma.mk/vesti/diplomatskiot-pasosh-na-mijalkov-od-denes-so-pechat-ponishteno>

²³Rasti Mijalkov – gabim njerëzor në procedurat e sigurisë. Telma. 17.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.telma.com.mk/vesti/sluhajok-mijalkov-chovechka-greshka-vo-bezbednosnite-proceduri>

²⁴Komisioni për mbikëqyrje të zbatimit të masave të posaçme hetimore ndjekje të komunikimeve, nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria për polici financiare, Drejtoria e doganave dhe Ministria për mbrojtje, dhe Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim.

²⁵Në seancë të pranishëm ishin edhe Avokati i popullit Ixhet Memeti, përfaqësues të MPB dhe të operatorëve “One”, “Vip” dhe “Telekom”, përfaqësues të shoqërisë qytetare por jo edhe ministri për punë të brendshme, Mitko Çavkov.

komisionit për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim mbajtën takim me Agjencinë për zbulim. Takimi u realizua me ftesë nga drejtori i Agjencisë dhe u diskutuan rreziqet e sigurisë me të cilat ballafaqohet shteti.²⁶

Për herë të parë pas shumë viteve, Drejtorët e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim ishin të pranishëm në seancë të Komisionit për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim, që u mbajt më 16 tetor. U diskutua mbi masat e ndërmarra për zbatimin e Reformave urgjente prioritare, por u parashtrua edhe pyetja se a vazhdojnë përgjimet e paligjshme. Por, për tu përgjigjur gjitha pyetjeve, drejtori i DSK thirri takim me dyer të mbyllura. Ftesa e tillë dhe raportet vjetore për punën e këtyre organeve u shqyrtuan në takimin e 19 tetorit.

Lustrimi

Më 15.10.2015 u konstatua se ueb-faqja e Komisionit për verifikim të fakteve nuk funksionon.²⁷

Reforma zgjedhore

Për shkak të paralajmërimit për largim të LSDM nga negociatat, u parashtrua pyetja nëse në të vërtetë të gjithë janë pajtuar me këtë pikë. Nga partia deklaruan se kjo nuk është e rëndësishme, kur është shkelur ajo që më parë është akorduar, sa i përket prokurorit special publik. Sipas lehtësuesit Vanhoute, megjithatë ka marrëveshje për legjislacionin zgjedhor.

Dihet se në Listën zgjedhore, përveç emrin dhe mbiemrit të votuesit do të qëndron edhe fotografia nga baza e fotografive të MPB për pasaportat biometrike.

Sipas deklaratës së përfaqësuesit të VMRO-DPMNE, është vendosur edhe mbi çështjen e votimit të diasporës. Deputetët nga diaspora do të votohen nëpërmjet modelit proporcional, që domethënë formimin e një njësie zgjedhore nga e cila do të zgjidhen tre deputet me së paku 6 000 vota. KSHZ do të vendos me shumicë absolute, kurse vetëm në raste të jashtëzakonshme do të zbatohet shumica e kualifikuar.²⁸ Përfaqësuesi i BDI deklaroi se gjatë vendimmarrjes në KSHZ do duhet të ketë edhe votë të përfaqësuesve shqiptar, si një formë e parimit të Badenterit. Sa i përket Listës zgjedhore, nuk do bëhet kontroll i tërësishëm i terrenit, por i pjesshëm, vetëm në rajone të caktuara kritike. Pastrimi do të bëhet nëpërmjet krahasimit të data-bazës.²⁹ Përfaqësimi i grave, reklamimi i paguar politik dhe financimi i kampanjave mbeten çështje të hapura.

Mediet: Liria e shprehjes

Shpifje

Me 1 tetor, Gjyqi themelor në Shtip solli vendim se biznesmeni Miki Naumov ka njollosur reputacionin dhe nderit e Zoran Zaevit. Zaevi nisi procedurën gjyqësore pas deklaratës së biznesmenit Naumov, se në maj të këtij viti i ka dhënë mitë në shumë prej 39 000 euro, në cilësi të kryetarit të komunës së Strumicës, kurse ka fituar hapësirë atraktive në qendrën tregtare Global.³⁰

²⁶Njoftim nga vizita e punës e mbajtur tek dhe Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim, në hapësirat e Agjencisë për zbulim më 15.10.2015. Ueb-faqja e Agjencisë për zbulim. 15.10.2015. Në dispozicion në:

<http://www.ia.gov.mk/pdf/%D0%A1%D0%BE%D0%BE%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5%20-%D0%9A%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%81%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

Shërbimet për zbulim kanë dorëzuar informatat për incidentin e Kumanovës tek kreu shtetëror. Ueb-faqja e LSDM. 15.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&aqlid=6&articleid=12524>

²⁷Informacioni vjen nga ndjekja e rregullt e punës së Komisionit për verifikim të fakteve tek Instituti për të drejta të njeriut.

²⁸Dimovski: Modeli zgjedhor mbetet i njëjtë, diaspora do të ketë deputet. MIA. 14.10.2015.

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/250/132847075>

²⁹A ka marrëveshje për Kodin zgjedhor? Telma. 14.10.2015. Në dispozicion në: <http://www.telma.com.mk/vesti/ima-li-dogovor-za-izborniot-zakonik>

³⁰Biznesmen nga Shtipi pohon se i ka dhënë mitë 39.000 euro Zaevit. Alfa Tv. 17.10.2015. Në dispozicion në:

<http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/273973-alfa-tv-biznismen-od-stip-tvr-di-deka-mu-dal-mito-na-zaev-od-39-000-evra>